

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8253 prot.

Tiranë, më 28.02.2024

V E N D I M

Nr. 24, datë 26.02.2024

**“PËR  
PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESËS PRIVATE, PALLATI NR. 5, RRUGA  
“FERIT XHAJKO”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 8, SI REZULTAT I DËMTIMIT  
NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 34, nenit 35, të aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, të ndryshuar, vendimit nr. 78, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, njësia administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji”, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë dhe shoqërisë “Tirana DC” SH.A, si njësi zbatuese”, të ndryshuar, si dhe në vijim të memos nr. 34404 prot., datë 30.09.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile me objekt “Mbi njohjen me aktekspertizat e thelluara të kryeta nga Operatorët Ekonomikë të kontraktuara nga Bashkia Tiranë, Oponencat Teknike të kryeta nga Instituti i Ndërtimit dhe vijimin e procedurave të mëtejshme, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesës private, pallati nr. 5, rruga “Ferit Xhajko”, të ndodhur në Njësinë Administrative nr. 8, Tiranë, mbështetur në akt ekspertizë të thelluar dhe konkluzionin e oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Bashkia Tiranë të trajtojë banorët e kësaj godine, si përditues të programeve të rindërtimit, në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi.

3. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi, (prishjen e objektit të dënuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.
4. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
5. Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve.
6. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit sipas këtij vendimi, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ndërhyrja për shembjen e objektit bëhet në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.
7. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit kërkon asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
8. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, si dhe afishohet në standat publike pranë Njesisë Administrative nr. 8, Tiranë.
9. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Monitorimit të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe Njesisë Administrative nr. 8, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETAR**

**ROMINA KUKO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Nr. 1750/prot

*[Handwritten signature]*  
Date 14/01/2021

L.ënda: Kthim përgjigje për kërkesën për plotësimet me vërejtjet dhe rekomandimet e akt ekspertizave të thelluara të operatorit ekonomik "Infrakonsult" sh.p.k.

BASHKISË TIRANË,

Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, administrimit të njësive administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Emergjencave Civile

Sheshi "Skënderbej", Nd.2, Kodi Postar 1001, Tiranë Rruga

Në bazë të kërkesës së Bashkisë Tiranë me Nr.39507 Prot. datë 11.10.2021, protokolluar me tonën me Nr.1750 Prot. datë.15.10.2021, "Kërkesë për plotësimet me vërejtjet dhe rekomandimet e akt ekspertizave të thelluara të operatorit ekonomik "Infrakonsult" sh.p.k.", po ju dërgojmë në 2 kopje kthimin e përgjigjes për projektet e plotësuara nga operatori ekonomik "Infrakonsult" sh.p.k. duke u bazuar në rekomandimet e lëna në oponentin teknik.

DREJTORI PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
INSTITUTI I NDËRTIMIT

KTHIM PËRGJIGJE PËR PROJEKTET E PLOTËSUAR NGA OPERATORI  
EKONOMIK "INFRAKONSULT" DUKE U BAZUAR NË REKOMANDIMET E  
LËNA NË Oponencën Teknike

Oponencat teknike të objekteve "Pallati Nr.3", Rr. "Haxhi Kika", Nj. Adm. Nr.5", "Pallati Nr.5", Rr. "Ferit Xhajko", Nj. Adm. Nr.8", "Pallati Nr.10", Rr. "Besim Daja", Nj. Adm. Nr.8"; "Pallati Nr.30", Rr. "Sami Frashëri", Nj. Adm. Nr.5", "Pallati Nr.39/43", Rr. "Ferit Xhajko", Nj. Adm. Nr.8", janë bërë mbi akt ekspertizat e thelluara të këtyre objekteve duke u bazuar në Nenin 34, të Aktit Normativ Nr.9 datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Akt ekspertizat e thelluara të këtyre objekteve, janë hartuar nga shoqëria "INFRAKONSULT" SH.P.K. me Ing. Konst. Sokol Metoja. Në secilin prej akt ekspertizave jepen analiza e gjendjes ekzistuese, të dhëna mbi materialet e ndërtimit, të dhenat nga projekti ekzistues, dëmtimet, studimet gjeologjike dhe sizmike, Teste dhe provat laboratorike, Projekti i përfortimit si dhe preventivi përkatës, etj

Bashkia Tiranë Referuar rekomandimeve të lëna nga ana e Oponencës Teknike, i është drejtuar operatori ekonomik "Infrakonsult" sh.p.k. me shkresën me Nr.19587/3Prot., datë 28.07.2021 me qëllim zbatimin e plotësimeve të akt ekspertizave nga ana e tyre. Sa më sipër, Bashkia Tiranë ka përcjellur shkresën me Nr.39507Prot., datë 11.10.2021 drejt Institutit të Ndërtimit, me projektet e plotësuara nga operatori ekonomik duke u bazuar në rekomandimet e lëna nga ana e Oponencës Teknike.

Pra në Oponencës Teknike janë paraqitur për secilin prej objekteve:

- Raportet mbi ndryshimet e bëra në bazë të rekomandimeve nga Oponenca Teknike mbi Akt Ekspertizën e Thelluar
- Akt Ekspertiza e Thelluar me ndryshimet përkatëse
- Projekti Konstruktiv i Përfortimit me ndryshimet përkatëse

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për plotësimin e rekomandimeve dhe vërjetjeve, Oponenca Teknike del në përfundimin që:

- Vërjetjet dhe Rekomandimet e lëna në Oponencën Teknike të objektit "Pallati Nr.3", Rr. "Haxhi Kika", Nj. Adm. Nr.5", përgjithësisht janë reflektuar në analizat e thelluara të objekteve si dhe në projektet e tyre të përfortimit.


Nga analiza e projektit të rishikuar dhe akt ekspertizës së rishikuar, si dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit, rekomandojmë që objekti "PALLATI NR.3, RR. "HAXHI KIKA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5, BASHKIA, TIRANË" të përfortohet dhe të Rikonstruktohet.

Projekti të zbatohet konform Eurokodit 8-3. Projekti si dhe Punimet e zbatimit të kryhen nga shoqëri të licensuara për këto lloj punimesh. Mënyrë përfortimit, projekti i përfortimit, saktësia e matjeve dhe e llogaritjeve si dhe preventivi i hartuar për këtë projekt, mbetet përgjegjësi e autorëve përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
INSTITUTI I NDËRTIMIT

- Vërejtjet dhe Rekomandimet e lëna në Oponencën Teknike të objektit “Pallati Nr.30”, Rr. “Sami Frashëri”, Nj. Adm. Nr.5”, përgjithësisht janë reflektuar në analizat e thelluara të objekteve si dhe në projektet e tyre të përforcimit.  
Nga analiza e projektit të rishikuar dhe akt ekspertizës së rishikuar si dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit, rekomandojmë që objekti “PALLATI NR.30”, RR. “SAMI FRASHËRI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.5, BASHKIA TIRANË, të Përforetet dhe të Rikonstruktoret.  
Projektet të zbatoret konform Eurokodit 8-3. Projektet si dhe Punimet e zbatimit të kryhen nga shoqërit të licensuara për këto lloj punimesh. Mënyra e përforcimit, projektet i përforcimit, saktësia e matjeve dhe e llogaritjeve si dhe preventivi i hartuar për këtë projekt, mbetet përgjegjësi e autorëve përkatës.
- Vërejtjet dhe Rekomandimet e lëna në Oponencën Teknike të objektit “Pallati Nr.5”, Rr. “Ferit Xhajko”, Nj. Adm. Nr.8”, përgjithësisht janë reflektuar në analizat e thelluara të objekteve si dhe në projektet e tyre të përforcimit.  
Nga analiza e projektit të rishikuar dhe akt ekspertizës së rishikuar si dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit, rekomandojmë që objekti “PALLATI NR.5”, RR. “FERIT XHAJKO”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.8, BASHKIA TIRANË, të Priset dhe të Ndërtoret nga e Para.  
Mënyra e përforcimit, projektet i përforcimit, saktësia e matjeve dhe e llogaritjeve si dhe preventivi i hartuar për këtë projekt, mbetet përgjegjësi e autorëve përkatës.
- Vërejtjet dhe Rekomandimet e lëna në Oponencën Teknike të objektit “Pallati Nr.10”, Rr. “Besim Daja”, Nj. Adm. Nr.8”, përgjithësisht janë reflektuar në analizat e thelluara të objekteve si dhe në projektet e tyre të përforcimit.  
*Autorët e akt ekspertizës shprehen se kanë kryer disa tentativa për të fotografuar dëmet në objektet si dhe për të kryer testimet e materialeve ndërtimore. Kjo gjë nuk ka qenë e mundur për shkak të banorëve të pallatit, të cilët nuk i kanë lejuar. Akt ekspertiza e thelluar nuk është bazuar mbi raportet laboratorike të materialeve ndërtimore, por është bazuar në parametrat teknike të materialeve ezksitues duke marrë parasysh degradimin që materialet kanë pësuar gjatë kohës së operimit të objektit. Gjithësesi për një vlerësim sa më të mirë të gjendjes faktike të objektit rekomandoret që analiza e thelluar të mbështet mbi rezultatet e provave të marru në terren për materialet ndërtimore.*  
Nga analiza e projektit të rishikuar dhe akt ekspertizës së rishikuar si dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit, rekomandojmë që objekti “PALLATI NR.10”, RR. “BESIM DAJA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.8, BASHKIA TIRANË, të Priset dhe të Ndërtoret nga e Para.  
Mënyra e përforcimit, projektet i përforcimit, saktësia e matjeve dhe e llogaritjeve si dhe preventivi i hartuar për këtë projekt, mbetet përgjegjësi e autorëve përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
INSTITUTI I NDËRTIMIT

- Vërejtjet dhe Rekomandimet e lëna në Oponencën Teknike të objektit “Pallati Nr.39/43”, Rr. “Ferit Xhajko”, Nj. Adm. Nr.8”, përgjithësisht janë reflektuar në analizat e thelluara të objekteve si dhe në projektet e tyre të përforcimit.  
*Përreth objektit janë realizuar shtesa b/a në të 3 anët e objektit. Sipas autorëve të projektit këto shtesa nuk janë të realizuara me fuga ndarëse nga objekti si dhe kanë sistem konstruktiv të ndryshëm nga ai i objektit (rama hapësimore b/a ose metalike). Shtesat variojnë nga 2 deri në 5 kate dhe nuk është marrë parasysh ndikimi i tyre në strukturën ekzistuese gjatë ndërtimit. Autorët shprehen se ndërhyrjet e shumta me shtesa dhe hapjet në muret e ndërtesës e kanë çenuar strukturë mbajtëse të objektit. Sipas autorëve shtesat e shumta ndikojnë negativisht në sjelljen e ndërtesës dhe duhet të hiqen të gjitha. Modelimi i objektit për të vlerësuar gjendjen ekzistuese është kryer së bashku me praninë e këtyre shtesave.*  
Nga analiza e projektit të rishikuar dhe akt ekspertizës së rishikuar si dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit, rekomandojmë që objekti “PALLATI NR.39/43”, RR. “FERIT XHAJKO”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.8, BASHKIA TIRANË, të Priset dhe të Ndërtohet nga e Para.  
Mënyra e përforcimit, projekti i përforcimit, saktësia e matjeve dhe e llogaritjeve si dhe preventivi i hartuar për këtë projekt, mbetet përgjegjësi e autorëve përkatës.

Punoi :

Ing. Gerti ÇELA



DREJTORE DREJTORIE  
Ing. Valbona PONDE

